

## SHTETET ISLAME NË OBI

### Hyrje

Organizata për Bashkëpunim Islamik - OBI, është një organizatë ndërqeveritare, e cila në vete numëron 57 shtete anëtare më të drejta të plota, si dhe 5 shtete me status vëzhgues. Shtetet e kësaj organizate shtrihen në 4 kontinente. Disa shtete tentojnë të anëtarësohen në OBI, mirëpo për disa mosmarrëveshje politike dhe territoriale me anëtarët e organizatës pengohen që të anëtarësohen.

OBI është organizata e dytë ndërqeveritare pas OKB - së. Kjo organizatë synon që të jetë zëri i përbashkët i botës islame në mbrojtjen e interesave dhe sigurimin e mirëqenies së vendeve anëtare në arenën ndërkombëtare.

Punimi ka për qëllim studimin e kësaj organizate në këndvështrimin gjeografik, në mënyrë që edhe lexuesi shqiptar të ketë njohuri për këtë organizatë, si dhe për shtetet që e formojnë atë. Studimi gjeografik i kësaj organizate nuk kompletohet vetëm më këtë përshkrim, pasi në këtë punim nuk është folur për aspektin demografik (popullsinë), ekonominë dhe resurset natyrore. Për këtë arsye, në mënyrë që të jemi korrektë me lexuesin, titullit të këtij punimi ia kemi shtuar numrin 1.

Punimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë është përshkruar pozita gjeografike, shtetet e organizatës, si dhe historia e krijimit të organizatës. Në pjesën e dytë janë përshkruar karakteristikat fiziko - gjeografike të hapësirës së shteteve të OBI - t.

## I. Pozita gjeografike, shtetet, dhe historia e krijimit të organizatës

### 1. 1. Pozita gjeografike

Organizata për Bashkëpunim Islamik - OBI (shtetet islame), është organizata e dytë ndërqeveritare pas Kombeve të Bashkuara, në të cilën janë të anëtarësuara 57 shtete, që shtrihen në katër kontinente: në Azi, Afrikë, Evropë, dhe në Amerikën Latine. Shumica dërrmuese e këtyre shteteve ndodhën në dy kontinente: në Afrikë dhe Azi.<sup>(1)</sup>

Bazuar në hartën e mëposhtme, shihet se në kontinentin e Afrikës ndodhën 27 shtete apo 47,37 %, në Azi 27 shtete apo 47,37%, në Amerikën Latine 2 shtete apo 3,51 %, si dhe në Evropë 1 shtet apo 1,75 %. Në aspektin e rajoneve gjeografike, shtetet e OBI - t shtrihen: në Afrikën Veriore 6 shtete apo 10,53 %, në Afrikën Perëndimore 13 shtete apo 22,81 %, në Afrikën Qendrore 3 shtete apo 5,26 %, në Afrikën Lindore 5 shtete apo 8,77 %, në Azinë Jugperëndimore 14 shtete apo 24,57 %, në Azinë Qendrore 5 shtete apo 8,77 %, në Azinë Jugore 5 shtete apo 8,77 %, në Azinë Juglindore 3 shtete apo 5,26 %, në Amerikën Jugore 2 shtete apo 3,51 %, si dhe në Evropën Jugore 1 shtet apo 1,75 %. Bazuar po në këtë hartë, shtetet e OBI - t shtrihen në të dy gjerësitë dhe në të dy gjatësitë gjeografike. Këto shtete shtrihen nga 56,4<sup>0</sup> të gjerësisë gjeografike veriore (Kazakistan) e deri në 26,8<sup>0</sup> të gjerësisë gjeografike jugore (Mozambik), si dhe nga 61,1<sup>0</sup> (Guajana) të gjatësisë gjeografike perëndimore e deri në 140,54<sup>0</sup> (Indonezi) të gjatësisë gjeografike lindore. Hapësira më e madhe e OBI - t ndodhet në hemisferën veriore. Po ashtu pjesa më e madhe e OBI - t është në gjatësinë gjeografike lindore.<sup>(2)</sup>

Bazuar në tabelën e mëposhtme, sipërfaqja e OBI - t, është rreth 29.091.707 km<sup>2</sup> ose përafërsisht 1/4 e sipërfaqes kontinentale të botës, e cila ka përafërsisht 149 milion km<sup>2</sup>. Numri i banorëve të shteteve të OBI - t, arrin në rreth 1.727 miliard banorë, që përbën 23,5 % të numrit të përgjithshëm të botës, prej rreth 7.336 miliard

<sup>(1)</sup> <http://www.oic-oci.org/oicv3/states/?lan=en>, shikuar më 12.06. 2016

<sup>(2)</sup> Artan S. Mehmeti, DITURIA ISLAME, numër 277 - 278, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2013, f. 33

banorë (viti 2015).<sup>(3)</sup>

Shtetet e OBI – t, kanë pozitë të përshtatshme gjeografike e gjeopolitike, sepse këtë pozitë më së miri ua mundëson:

1. Shtrirja gjeografike në katër kontinente (Afrikë, Azi, Amerikë e Jugut, dhe Evropë)
2. Shumica e shteteve shtrihen në qendër të globit tokësor (shtetet e Afrikës Veriore, Afrikës Perëndimore, Afrikës Lindore, Azisë Jugperëndimore, Azisë Qendrore, si dhe Evropës Jugore)
3. Në hapësirën e OBI – t ndodhën edhe ngushticat më të rëndësishmeqëshërbejnësiuralidhësenëmeskontinenteve. Nëpër këto ngushtica kalojnë rrugë të rëndësishme detare (Ngushtica e Gjibraltarit, e Dardaneleve, e Bosforit, Kanali i Suezit<sup>(4)</sup>, Ngushtica e Otrantos etj.)
4. Hapësira e OBI – t, ka dalje në tri nga katër oqeanet e j planetit Tokë (Oqeani Atlantik, Indian, Paqësor), si dhe në një numër të madh detesh e gjiresh
5. Nëpër këtë territor kalojnë rrugë tokësore, detare dhe ajrore me rëndësi ndërkombëtare, nga të cilat realizohen të ardhura të mira nga trafiku botëror.

### **1. 2. Shtetet e Organizatës për Bashkëpunim Islamik – OBI**

Siç u cek edhe më lart, OBI, ka gjithsej 57 shtete. Në kontinentin e Afrikës ndodhën 27, në Azi ndodhën 27 shtete, në Amerikën Latine 2 shtete, si dhe në Evropë 1 shtet.

Shtetet që ndodhën në kontinentin e Afrikës janë: 1. Uganda 2. Benini 3. Burkina Faso 4. Çadi 5. Tunizia 6. Algjeria 7. Bregu i Fildishtë 8. Xhibuti 9. Senegali 10. Sudani (më 9 korrik 2011, Sudanit i ndahet Sudani Jugor më shumicë të popullsisë krishtere – katolike) 11. Sierra Leone 12. Somalia 13. Togo 14. Gaboni 15. Gambia 16. Guineja 17. Guineja Bisao 18. Kameruni 19. Libia 20. Mali 21. Egjipti 22. Maroku 23. Muaritania 24. Mozambiku 25.

---

<sup>(3)</sup> 2015 World Population Data Sheet with a special focus on women's empowerment. f. 11. ([http://www.prb.org/pdf15/2015-world-population-data-sheet\\_eng.pdf](http://www.prb.org/pdf15/2015-world-population-data-sheet_eng.pdf)), shikuar më 19.07. 2016

<sup>(4)</sup> Është kanal jo natyral, por i hapur nga njeriu, për të bashkuar Detin Mesdhe me Oqeanin Indian, si rrugë më e afërt për në Indi.

Nigeri 26. Nigeria 27. Ishujt Komore.

Shtetet që ndodhën në kontinentin e Azisë janë: 1. Azerbajxhani 2. Jordania 3. Uzbekistani 4. Afganistani 5. Emiratet e Bashkuara Arabe 6. Indonezia 7. Irani 8. Pakistani 9. Bahrejni 10. Brunei 11. Bangladeshi 12. Turqia 13. Turkmenistani 14. Arabia Saudite 15. Siria 16. Taxhikistani 17. Iraku 18. Omani 19. Palestina 20. Kirgistani 21. Katari 22. Kazakistani 23. Kuvajti 24. Libani 25. Ishujt Maldive 26. Malajzia 27. Jemeni.

Shtetet që ndodhën në kontinentin e Azisë janë: 1. Surinami 2. Guajana. Shteti që ndodhet në kontinentin e Evropës është Shqipëria.

Përveç shteteve anëtare, në OBI janë edhe 5 shtete të cilat nuk janë anëtare të kësaj organizate, mirëpo kanë status vëzhgues. Gjatë punimeve të kësaj organizate këto 5 shtete nuk kanë të drejtë vote në vendimmarrje. Shtetet që kanë status vëzhgues në Organizatën për Bashkëpunim Islamik janë: 1. Rusia 2. Republika e Afrikës Qendrore 3. Tajlanda 4. Bosnja dhe Hercegovina 5. Qipro Veriore.<sup>(5)</sup>

Dy shtete tentojnë të anëtarësohen në OBI, mirëpo për disa mosmarrëveshje politike dhe territoriale me anëtarët e organizatës, ato pengohen që të anëtarësohen. Këto shtete janë India dhe Filipinet.<sup>(6)</sup>

Disa shtete edhe pse kanë përqindje të madhe të popullsisë myslimane, nuk janë anëtare të OBI - t. Prej këtyre shteteve, e vetmja, Bosnja dhe Hercegovina, ka status vëzhgues. Shtetet që kanë përqindje të madhe të popullsisë dhe nuk janë anëtare të OBI - t janë: 1. Saharaja Perëndimore, me 99,6 % të popullsisë myslimane (ndodhet në Afrikën Perëndimore, në OKB ka statusin e shtetit vëzhgues) 2. Ishujt Mayotte, me 98,8 % të popullsisë myslimane (këta ishuj ndodhen në Afrikën Lindore dhe janë koloni franceze që nga viti 1841. Ishujt Mayotte kanë 92 % të popullsisë me kombësi komoriane.<sup>(7)</sup>) 3. Bosnja dhe Hercegovina, me 41,6 % të popullsisë myslimane (është anëtare më status vëzhgues në OBI) 4. Eritreja, me 36,5 % të popullsisë myslimane, 5.

<sup>(5)</sup> Po aty, f. 33

<sup>(6)</sup> [http://en.wikipedia.org/wiki/Member\\_states\\_of\\_the\\_Organisation\\_of\\_Islamic\\_Cooperation](http://en.wikipedia.org/wiki/Member_states_of_the_Organisation_of_Islamic_Cooperation), shikuar më 18.06. 2016

<sup>(7)</sup> <http://www.worldstatesmen.org/Mayotte.htm>, shikuar më 18.06. 2016

Maqedonia, me 34.9 % të popullsisë myslimane 6. Etiopia, me 33,8 % të popullsisë myslimane 7. Tanzania, me 29,9 % të popullsisë myslimane 8. Kosova, me rreth 91,7 % të popullsisë myslimane (Sipas regjistrimit të fundit, të kryer në vitin 2001, sillet shifra prej 98 %. Nuk njihet si vend i pavarur nga të gjitha shtetet anëtare të OBI - t, edhe pse është miratuar një rezolutë e cila ju bën thirrje shteteve anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën, që ta njohin si shtet të pavarur). Nga ana tjetër, disa shtete kanë përqindje shumë të vogël në krahasim me këto shtete, mirëpo janë anëtare të OBI - t me të drejta të plota, e këto janë: 1. Guajana, me 7,2 % të popullsisë myslimane, 2. Gaboni, me 9,7 % të popullsisë myslimane 3. Uganda, me 12,0 % të popullsisë myslimane 4. Togo, me 12,2 % të popullsisë myslimane 5. Surinami, me 15,9 % të popullsisë myslimane 6. Kameruni, me 18,0 % të popullsisë myslimane. Këtyre shteteve, për nga përqindja e popullsisë myslimane, ua kalojnë edhe disa shtete tjera, të cilat zyrtarisht njihen si shtete jo myslimane, si: 1. Mauritani, me 19,6 % të popullsisë myslimane 2. Gana, me 16.1 % të popullsisë myslimane 3. Bullgaria, me 13, 4 % të popullsisë myslimane s 4. Gjeorgjia, me 10. 5 % të popullsisë myslimane etj.<sup>(8)</sup>

Shteti me sipërfaqe më të madhe në OBI, është Kazakistani<sup>(9)</sup>, me rreth 2.724.900 km<sup>2</sup>, i pasuar nga Algjeria, me rreth 2.381.741 km<sup>2</sup> dhe Arabia Sauditee më rreth 2.149.690 km<sup>2</sup>. Ndërkaq, shtetet me sipërfaqe më të vogël janë Ishujt Maldive, me rreth 300 km<sup>2</sup>, pasojnë Bahrejni, me rreth 765 km<sup>2</sup> dhe Ishujt Komore, me rreth 1.862 km<sup>2</sup>.

Indonezia është shteti islam që ka më së shumti banorë, me rreth 255.7 milion banorë, i pasuar nga Pakistani, m rreth 199.0 milion banorë dhe Nigeria, me rreth 181.8 milion banorë. Vetëm këto tri shtete përbëjnë 36,9 % të numrit të gjithëmbarshtëm të banorëve të OBI - t. Ishujt Maldive dhe Brunei janë shtetet me numër më të vogël të banorëve, me rreth 300.000 banorë, të pasua nga Brunei, me 400.000, dhe Guajana, me rreth 700.000 banorë.

Sipas një studimi të vitit 2010, del se shteti që ka përqindjen më të madhe të popullsisë myslimane është Maroku, me 99.9 % të popullsisë, i pasuar nga Afganistani dhe Tunizia, me 99.8 % të

<sup>(8)</sup> <http://features.pewforum.org/muslim-population/>, shikuar më 18.06. 2016

<sup>(9)</sup> Kazakistani është shteti i 9tw më i madh në botë për nga sipërfaqja

popullsisë. Shteti që ka më pak përqindje të popullsisë myslimane është Guajana, me 7.2 % të popullsisë, i pasuar nga Gaboni, me 9.7 % të popullsisë, si dhe Uganda, me 12.0 % të popullsisë. Përqindja mesatare e myslimaneve në hapësirën e OBI - t është 75,6 % e popullsisë.

### 1. 3. Historia e krijimit të Organizatës për Bashkëpunim Islamik - OBI

Organizata synon që të jetë zëri i përbashkët i botës islame, e cila i mbron interesat e saj dhe siguron që progresi i mirëqenies së vendeve anëtare të vazhdojë në një atmosferë të paqes ndërkombëtare.<sup>(10)</sup>

OBI është themeluar më 25 shtator 1969, gjatë samitit që u mbajt në Mbretërinë e Marokut. Mbajtja e samitit ishte si rezultat i zjarrvënies së xhamisë së shenjtë Al - Aksa, që ndodhet në Jerusalem, i cili është i pushtuar nga Izraeli. Prej themelimit deri më sot numri i shteteve është rritur nga 25 shtete themeluese në 57 shtete anëtare, sa ka sot organizata (Shih tabelën). Nevoja për themelimin e një organizate të tillë lindi si pasojë e rrethanave të krijuara pas Luftës së Parë Botërore, kur u shkatërrua edhe Kalifati (me shuarjen e perandorisë osmane që pasoi krijimin e shtetit të Turqisë). Situata u rëndua edhe më shumë pas humbjes së luftës 6- ditore në vitin 1967 të shteteve islame nga Izraeli. Organizata e ka themeluar kartën e vet të të drejtave të njeriut, e njohur si Deklarata e Kajros mbi të drejtat e njeriut në islam.<sup>(11)</sup>

Gjuhët zyrtare të OBI - t janë: *gjuha arabe, gjuha angleze dhe gjuha frënge*. Selia e organizatës ndodhet në qytetin *Xheda* të Arabisë Saudite. OBI ka një delegacion permanent në Kombet e Bashkuara. Kjo organizatë paraqitet si përfaqësuese e përgjithshme e botëkuptimeve islame në botë.<sup>(12)</sup>

<sup>(10)</sup> Artan S. Mehmeti, DITURIA ISLAME ....., f. 33

<sup>(11)</sup> Po aty, f. 34

<sup>(12)</sup> Po aty, f. 34

## II. Karakteristikat fiziko - gjeografike

### 2. 1. *Relievi*<sup>(13)</sup>

Sipërfaqja e madhe prej rreth 29.091.707 km<sup>2</sup>, si dhe shtrirja në katër kontinentet (Azi, Afrikë, Evropë, Amerikë e Jugut), ka bërë të mundur që në këtë hapësirë të hasen pothuajse të gjitha format relievore. Në hapësirën e shteteve të OBI - t, shtrihen një numër relativisht i madh i maleve, rrafshnaltave, ultësirave, shkretëtirave, gadishujve, ishujve, luginave lumore, kanioneve etj. Pika më e ulët e kësaj hapësire është 0 m përgjatë vijës bregdetare, kurse pika më e lartë është 7.785 km që ndodhët në Himalaje, në hapësirën e Pakistanit Verior.

**Malet.** Malet kryesore në hapësirën e shteteve afrikane janë: Malet Atlas, Ahgar, Tibesti, D**Malet**-Endi, malet e Kamerunit, Buçi, Ogaden, Benadir Shrihen, Ekuatoria, Ndota, Ungoni, Mashonalend, Luska; malet e shteteve aziatike janë: Malet Taurus, Xhabal an Nusayriyah, Pontike, Kaukazi, El Hexhas, Tihama, Asir, Hadramaut, Kurdistanit, Zargos, malet e Iranit, Kush Rud, Beluxhista, Elbrus, Kopet Dog, malet e Afganistanit, Indokushi, Himalajet, Pamir, Kirgit, Tian Shan, Malet e Bardha, Malet Qendrore, Miles, Iran, Barisano në Ishullin Sumatra (Indonezi) etj.; malet e shteteve të Amerikës Jugore janë: Malet e Guajanës; malet në Evropë - Shqipëri janë: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nëmura etj.

**Rrafshnaltat.** Mes kreshtave malore që ndodhen në hapësirën e shteteve të OBI - t, shtrihen rrafshnalta të shumta, ku më kryesoret janë në Afrikë: Erdi, Idhan, Tademajt, Andar, Idhan Mazruk, Sarir Tibesti, rrafshnalta e Etiopisë, rrafshnalta e Sudanit, Adror Iforas, rrafshnaltat e Kamerunit, Nigerisë, Guinës, Ugandës, Mozambikut, Gabonit etj.; në Azi: rrafshnalta e Arabisë, Iranit, Anadollit, Ustjurtskut, Kazashit, Kara - Kum etj.; në Amerikën Latine: rrafshnaltat në Malet e Guajanës; në Evropë rrafshnaltat në malet veriore dhe verilindore të Shqipërisë (Kukësit, Korçës, Dibrës etj.).

---

<sup>(13)</sup> Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - I (KONTINENTI I EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - II (KONTINENTET JASHTË EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); ATLAS GJEOGRAFIK, TRIMAKS, Shkup 2008. I përpunoi autori.

**Shkretëtirat.** Relievi shkretinor i këtyre shteteve shtrihet vetëm në kontinentin e Azisë dhe Afrikës. Shkretëtirat e kësaj hapësire janë në Afrikë: Saharaja, shkretëtirat e Arabisë, Nubisë, Libisë, Ergu i Madh Lindor dhe Shkretëtira Perëndimore; në Azi: shkretëtira Nefud, Dena, Margo, Registan, Tar, Shkretëtira e Madhe e Njelmët, Lutë, Mujunkum, Sari Ishkontrahu, Kara - Kum, Kizi - Kum, shkretëtira e Sirisë etj.<sup>(14)</sup>

**Ultësirat.** Ultësirat e shteteve të OBI - t, më tepër janë të lidhura më rrjedhjet e lumenjve. Ultësirat kryesore që shtrihen në hapësirat e shteteve të OBI -t janë në Afrikë: Ultësira e Afrikës Perëndimore, Fushëgropa e Bodelesë, Ultësira e deltës së Nilit etj; në Azi: Ultësira e Mesopotamisë, e Brigjeve të Kaspikut, e Turanes, e Hindustanit, ultësira e rrjedhjes së poshtme të lumit Ind etj; në Amerikën Latine: ultësira përgjatë lumenjve Kujuni, Esekibo, Kourrantine, Maroni; në Evropë: ultësira e Shqipërisë Perëndimore.

**Gadishujt.** Shtetet e OBI - t, shtrihen në një numër të konsiderueshëm të gadishujve, ku më kryesoret janë në Afrikë: gadishulli i Somalisë; në Azi: Gadishulli Arabik, i Malajës, i Azisë së Vogël, i Sinajit etj; në Evropë: gadishulli i Ballkanit.

**Ishujt.** Bota islame disponon edhe ujdhesat më të mëdha në botë, të cilat janë kryesisht në Malajzi dhe Indonezi. Ishujt më kryesorë të shteteve të OBI - t janë në Afrikë: ishujt Komore, si dhe disa ishuj të vegjël të shteteve përkatëse; në Azi: ishulli Kalimantan, Sumatra, Java, Guajana, Timori, Sulavesi, dhe qindra ishuj që e formojnë Indonezinë, si ishujt Maldive, Bahrejni, si dhe disa ishuj në pjesën perëndimore të Turqisë; në Evropë janë: ishulli Sazanit si dhe ishujt e Ksamilit.

---

<sup>(14)</sup> <http://www.zeriyt.com/shkretetirat-neper-bote-t25763.0.html>, shikuar më 22.06. 2016

## 2. 2. Klima<sup>(15)</sup>

Sipërfaqja e madhe e shteteve të OBI - t, e cila shtrihet në katër kontinente, shtrirja e këtyre shteteve në të dy gjerësitë dhe gjatësitë gjeografike, konfrontimi i masave ajrore kontinentale - detare e tropikale, ndikimi i deteve dhe oqeanëve, shtrirja e vargjeve malore perëndim - lindje e veri - jug, lartësia e madhe mbidetare e disa rajoneve, shumëllojshmëria e botës bimore dhe shpërndarja e tyre në hapësirën e këtyre shteteve, si dhe disa faktorë të tjerë kanë ndikuar që në hapësirën e këtyre shteteve të jenë të pranishme pothuajse të gjitha llojet e klimës.

Përshkrimi i klimës është bërë në kuadër të regjioneve gjeografike, në të cilat shtrihen këto shtete, si në Afrikën Veriore, Afrikën Perëndimore, Afrikën Qendrore, Afrikën Lindore, Azinë Jugperëndimore, Azinë Qendrore, Azinë Jugore, Azinë Juglindore, pjesën veriore të Amerikës Jugore dhe Evropën Juglindore.

Në Afrikën Veriore, në zonën e Mesdheut dominon klima mesdhetare, në lartësi klima e mesme kontinentale dhe në jug klima steposhkretinore.

Në Afrikën Perëndimore, dominon klima tropikale me variantet ekuatoriale deri në shkretinore izohietët prej 2.000 mm deri në 1.000 mm reshje shtrihen në zonën ekuatoriale dhe tropikale, kurse reshjet prej 300 mm kufizohen në gjerësinë gjeografike veriore 18<sup>0</sup>, në zonën e gjysmëshkretëtirave.

Afrika Qendrore ka klimë të nxehtë tropikale ekuatoriale me temperaturë mesatare ajrore 24 - 27 °C dhe me shira të përditshme me mbi 2.000 mm në vit.

Klima e Afrikës Lindore është më e freskët, pa vapë të theksuar dhe pa lagështi të madhe relative. Rreth 80 % e reshjeve bien në periudhën qershor - shtator. Zona e Mozambikut dhe e ishujve Komore kanë klimë ekuatoriale. Hapësira e madhe oqeanike sjell reshje të bollshme. Pasatet juglindore lagin ishujt Komore dhe bregdetin e Mozambikut dhe sjellin sasi të reshjeve që sillen rreth 700 - 2.000 mm.

---

<sup>(15)</sup>Marrë nga: Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - I (KONTINENTI I EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - II (KONTINENTET JASHTË EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); ATLAS GJEOGRAFIK, TRIMAKS, Shkup 2008. I përpunoi autori.

Në hapësirën më të madhe të Azisë Jugperëndimore dominon klima e thatë kontinentale. Prej bregdetit nga brenda dominon klima e thatë kontinentale, ku reshjet nuk kalojnë mbi 250 mm në vit. Në brigjet e Mesdheut dominon klima mesdhetare, që është klima më e mirë e rajonit. Në jugperëndim të Siujdhesës së Arabisë dhe në Jemen dominon klima e theksuar tropikale, që dallohet për nxehtësi dhe reshje shiu që i sjellin erërat detare. Vise me reshje të theksuara janë malet e larta të Azisë së Vogël.

Në Azinë Qendrore janë prezente klima kontinentale, e ashpër kontinentale, e thatë kontinentale, e thatë shkretinore dhe subtropikale. Në pjesët veriore dhe verilindore, temperaturat verore mund të arrijnë 45 °C, ndërsa të dimrit në 45 °C. Në korrikun e vitit 1983, qyteti i Turkmenistanit i quajtur Amu Darya, regjistroi temperaturën prej 51.7 °C. Kjo vlerë është jozyrtare. Temperatura më e lartë është regjistruar në Rezervat Repetek, po ashtu në Turkmenistan me 50.1 °C, e njohur si temperatura më e lartë e regjistruar ndonjëherë në tërë ish - Bashkimin Sovjetik. Sasia e reshjeve sillet nga 3.000 mm në pjesët veriore dhe verilindore, ndërsa në shkretëtira më pak se 100 mm në vit;

Karakteristikat klimatike të Azisë jugore janë erërat monsunike. Gjatë verës fyejnë prej shtypjes së lartë barike detare, ka shtypja e ulët barike në kontinent dhe anasjelltas gjatë dimrit. Monsunet dimërore janë të thata dhe jo të ftohtë. Monsunet verore fryjnë prej Detit Arabik dhe gjirit të Bengalit, duke krijuar kështu 7 - 8 perioda shiu dhe vape;

Karakteristikat klimatike të Azisë Juglindore i japin monsunet. Brendësia e Indokinës ka klimë tropike kontinentale monsunike, bregdeti ka klimë tropike martine monsunike, skaji jugor i siujdhesës ka klimë ekuatoriale, arkipelagu i Malajesë ka klimë ekuatoriale monsunike. Në përgjithësi është rajon me lagështi e temperaturë të lartë.

Pjesa veriore e Amerikës Jugore ku ndodhën këto dy shtete ka klimë ekuatoriale. Në këtë zonë klimatike temperatura ajrore nuk zbret nën 20 °C, reshjet mesatare janë 1.000 - 7.000 mm, të cilat i shkaktajnë erërat jugore dhe jugperëndimore.

Shqipëria bën pjesë në brezin subtropikal dhe përfshihet në zonën e klimës mesdhetare, me dimër të shkurtër e të butë dhe me verë të nxehtë e shumë të thatë. Bien mesatarisht 1.430 mm reshje në vit dhe vijnë duke u pakësuar nga perëndimi në lindje.

### 2. 3. Ujërat<sup>(16)</sup>

Ujërat mbulojnë një pjesë të vogël të shteteve të OBI - t. Kjo hapësirë është pak më shumë se 500.000 km<sup>2</sup> dhe në të rrjedhin lumenjtë më të rëndësishëm e më të gjatë në botë, si: Nili, Nigeri, Shat al Arab bashkë me dy degët e tij Tigër dhe Eufrat etj. Hapësira e madhe territoriale e shteteve të OBI - t, ka bërë të mundur që kjo hapësirë të laget nga detet dhe oqeanet më të rëndësishme të botës. Kufiri detar i këtyre shteteve është përafërsisht 102.347 km.<sup>(17)</sup>

Edhe përshkrimi i ujërave është bërë në kuadër të regjioneve gjeografike në të cilat shtrihen shtetet e OBI - t.

**Lumenjtë.** Lumenjtë e Afrikës Veriore janë të shkurtër. Në hapësirën shkretinore janë uadet (shtretër të tharë lumorë, të cilët kanë ujë vetëm kur bie shi). Lumenjtë kryesorë të këtij rajoni janë: Nili me degët e tij, Muluja, Rubja. Bazuar në kushtet klimatike, Afrika Perëndimore është e pasur më rrjedhje lumore. Lumenjtë më kryesorë janë: Nigeri, Senegali, Volta, Komandugu, Komoe, Sasandra, së bashku me degët e tyre. Këta lumenj janë të pasur më potenciale hidroenergjike dhe ujtitëse. Afrika Qendrore apo Ekuatoriale është pjesa më e pasur më ujëra në kontinentin e Afrikës, për arsye se lumenjtë kalojnë nëpër zonat e shirave zenitore që përsëriten dy herë në vit, si dhe në zonën ekuatoriale, të shirave të përditshëm. Lumenjtë kryesorë janë: Ubangi me degët e tij, Ogoue, Sanga, Shari. Afrika Lindore ka rrjet të zhvilluar hidrografik. Prej lumenjve kryesorë janë: Vebi Shebeli, Xhuba, Nili i Bardhë Zambezi, Limpopo, Lurio, Mesalu etj. Klima e thatë e Azisë Jugperëndimore ka kushtëzuar varfëri të rrjedhjeve lumore, ku rrallëherë vërehet ndonjë rrjedhje e përhershme ujore. Rrjedhjet e përhershme ujore hasen më tepër në pjesët e Azisë së Vogël, në brigjet e Detit të Zi, si dhe në Mesopotami.

<sup>(16)</sup> Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - I (KONTINENTI I EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - II (KONTINENTET JASHTË EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); ATLAS GJEOGRAFIK, TRIMAKS, Shkup 2008. I përpunoi autori.

<sup>(17)</sup> Dr. Sabir Ahmed Taha, RËNDËSIA E POZITËS GJEOGRAFIKE TË BOTËS ISLAME (<https://sedatislami.wordpress.com/2011/12/29/rendesia-e-pozites-gjeografike-te-botes-islame/>) shikuar më 25.06. 2016

Lumenjtë kryesorë janë: Shat al Arab bashkë me dy degët e tij Tigër dhe Euftrat, Kizil Irmak, Sakarja, Jordan, Arake, Wadi al Masilah etj.; Shtetet e Azisë Qendrore kanë një rrjet të dendur hidrografik. Lumenjtë kryesorë të këtyre shteteve janë: Amu Darja, Samu Darja, Ural, Çu, Irtish, Hilmend, Trak etj. Azia Jugore ka një rrjet të dendur hidrografik. Lumenjtë kryesorë të këtyre shteteve janë: Indi, Gangë, Bramaputra, Hindi, Hingol etj. Përveç rrjedhjeve lumore, Azia Juglindore nuk shquhet për forma të tjera ujore. Lumenjtë kryesorë janë: Rokan, Hari, Kompur, Mohakam etj. Reshjet e bollshme, si dhe shtresat joujëlëshuese kanë kushtëzuar një rrjet të dendur të lumenjve në Amerikën Jugore. Lumenjtë kryesorë të këtyre shteteve janë: Copenname, Suriname, Tapanahoni, Rupununi, Essequibo, Courantyne River, Mazaruni etj. Evropa Jugore po ashtu përshkruhet më një rrjet të dendur hidrografik. Lumenjtë kryesorë të Shqipërisë janë: Vjosa, Devolli, Osumi, Shkumbini, Erzeni, Mati, Drini etj.

**Liqenet.** Në hapësirën e shteteve të OBI - t, gjenden një numër i madh i liqeneve, duke i përfshirë edhe liqenet më kryesore të botës. Liqenet kryesore që ndodhen në këtë hapësirë janë: liqeni Melrir, Jerid, Jerid, Naserian etj., në Afrikën Veriore; liqeni Kosu, Volta etj., në Afrikën Perëndimore; liqeni Çad, Lagdo etj., në Afrikën Qendrore; liqeni Viktoria, Kjoga, Albert, Eduard, Malavi në Afrikën Lindore; liqeni Tuz, Van, Urmia, Nemek, Nomaksar, Horel Humar, Sania, Liqeni i Vdekur, Derjaç Nemek etj., në Azinë Jugperëndimore; liqeni Aral, Kaspik, Balkheshit, Zajsan, Sasi Kol, Ala Kol, Isik Kul etj., në Azinë Qendrore; liqeni Dor, Gaudizira, Hamun Mashkel etj., në Azinë Jugore; liqeni Toba, Tovuti, Poso etj., në Azinë Juglindore; liqeni Brokopobdo Stuwmeer etj., në Amerikën Jugore; liqeni i Shkodrës, Ohrit, Prespës etj., në Evropën Jugore.

**Oqeanet dhe detet.** Hapësira e shteteve të OBI - t, ka dalje në 3 nga 4 oqeanet sa ka gjithsej planeti Tokë: në Oqeani Indian, Oqeanin Paqësor, si dhe në Oqeanin Atlantik. Brigjet e kësaj hapësire lagen edhe nga një numër i madh detesh dhe gjiresh, si: Deti Mesdhe, Deti i Kuq, gjiri i Adenit, deti i Arabisë, gjiri i Omanit, Gjiri Persik, gjiri i Bengalit, deti i Andamaneve, deti i Javës, deti i Florës, deti Arafur, deti i Bandit, deti i Ceramit, deti Moluk, Deti i Kinës Jugore, deti Jon, deti Adriatik.

#### 2. 4. Bota bimore dhe shtazore<sup>(18)</sup>

**Bota bimore.** Bota bimore është e lidhur ngushtë me shumëllojshmërinë e klimës. Varësisht zonave klimatike, në hapësirën e shteteve të OBI - t diferencohen disa zona bimore. Bimësia e lartë malore është e përhapur në Afrikën Veriore, Afrikën Lindore, si dhe Azinë Jugperëndimore. Zona e pyjeve gjetmbajtëse shtrihet në Azinë Jugore, si dhe Azinë Juglindore. Zona e pyjeve gjetmbajtëse shtrihet në hapësirën e Afrikës Lindore, Azisë Jugperëndimore, si dhe në Evropën Jugore. Zona e stepave shtrihet në hapësirën e Azisë Qendrore. Zona e shkretëtirave, e cila është zona që ka shtrirje më të madhe në hapësirën e këtyre shteteve, shtrihet në hapësirën e Afrikës Veriore, Afrikën Perëndimore, Afrikën Qendrore, Afrikën Lindore, Azinë Jugperëndimore, Azinë Qendrore, si dhe Azinë Jugore. Zona e Savaneve shtrihet në zonën e Afrikës Perëndimore, Afrikës Qendrore, si dhe Afrikës Lindore. Zona e pyjeve tropikale (xhunglës ekuatoriale) shtrihet në hapësirën e Afrikës Perëndimore, Afrikës Qendrore, Azisë Jugore, si dhe Amerikës Jugore.

**Bota shtazore.** Hapësira e shteteve të OBI - t, është e pasur me një shumëllojshmëri të botës shtazore. Në këtë hapësirë jetojnë një numër i madh i kafshëve mishngrënëse, siç janë: luani, tigri, leopardi, puma, ariu, jku, hiena, dhelpra, rrëqebulli etj.; një numër i madh i kafshëve barngrënëse, siç janë: bualli, hipopotami, elefanti, zebra, gjirafa, panda, antilopa, dreri, kuajt, lopët, delet, devetë etj.; një numër i madh i zvarranikëve, siç janë: krokodili, kameleoni, breshka, hardhuca, një numër i madh i llojeve të gjarpërinjve helmues dhe johelmues etj.; një numër i madh i shpendëve, si dhe insekteve. Në këtë hapësirë jetojnë edhe disa lloje të majmunëve.

---

<sup>(18)</sup> Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - I (KONTINENTI I EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); Dr. Hajriz Meleqi, GJEOGRAFIA REGJIONALE - II (KONTINENTET JASHTË EVROPËS), Prishtinë 2008, (Dispenc); ATLAS GJEOGRAFIK, TRIMAKS, Shkup 2008. I përpunoi autori.